

"QYTETI I ARTEVE"

2010





Das një punë të gjatë dhe këmbëngulëse të Rektoratit të Akademisë së Arteve pranë Qeverisë së Shqipërisë dhe me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit Z. Sali Berisha, u arrit që për herë të parë të themelohet programi "Qyteti i Arteve".

PROF. PETRIT MALAJ
REKTOR

AKADEMIA E ARTEVE
TIRANE

"QYTETI I ARTEVE"
2010



Ky program mbështetet me fonde të akorduara nga Qeveria e Shqipërisë dhe është në funksion të realizimit të projekteve artistike nga studentët dhe personeli akademik pranë Akademisë së Arteve në të gjitha fushat e krijimtarisë artistike në Muzikë, Art Skenik dhe Artet e Bukura.

Akademia e Arteve, në kuadrin e pasurimit të jetës artistike në vend, rritjen e konkurrencës në tregun artistik, si dhe për rritjen e mundësisë së personelit akademik dhe studentor që të prezantojnë arritjet më të mira krijuese dhe interpretuese të këtij institucioni, me mbështetjen e

Qeverisë Shqiptare, për herë të parë, arrin të realizojë një moment shumë të rëndësishëm të strategjisë së saj, krijimin e Programit, "QYTETI I ARTEVE".

Objektivat e Programit "Qyteti i Arteve" kanë të bëjnë me mbështetjen e krijimtarisë në të gjitha fushat e artit që edukohen dhe zhvillohen brenda AA-së, ngritjen e cilësisë artistike të interpretimit, ekzekutimit dhe krijimtarisë. Po ashtu ky program do të ndikojë dukshëm në zhvillimin e marketingut në ambientet e Akademisë së Arteve dhe rritjen e vizibilitetit të AA-së nëpërmjet publicitetit të ngjarjeve që financo Programi.

Këmbëngulja jonë do të konsistojë në krijimin e ngjarjeve me qendrueshmëri dhe vazhdimësi si, festivale muzikore, promovime të filmave të regjizorëve të rinj, opera, teatër, koncerte muzikore, ekspozita, danc teatër apo master-class-e të cilat do kurorëzohen me një ngjarje, ose event artistik, pra, veprimtari që do të kenë impakt në të ardhmen në veprimtari kombëtare ose ndërkombëtare.

"QYTETI I ARTEVE"

Objektivat

- Të mbështesë krijimtarinë në të gjitha fushat e artit që edukohen dhe zhvillohen brenda AA-së.
- Të ngrejë cilësinë artistike të interpretimit, ekzekutimit dhe krijimtarisë.
- Të zhvillojë marketingun në ambientet e Akademisë së Arteve.
- Të rrisë vizibilitetin e AA-së nëpërmjet publicitetit të ngjarjeve që financo Programi.
- Të krijojnë ngjarje me qendrueshmëri dhe vazhdimësi p.sh. bienale e artistëve të rinj, festivale muzikore, të filmit të regjizorëve të rinj, ose master-class-e të cilat kurorëzohen me një ngjarje, ose event artistik etj., pra veprimtari që të shndërrohen dhe të kenë impakt në të ardhmen në veprimtari kombëtare ose ndërkombëtare.



VIZIONI I PROGRAMIT DHE PRIORITETET:


Për realizimin me sukses të këtij Programi duhet të shihen si prioritet dhe të arrihen këto objektiva:

- Shpërfaqja e vlerave dhe potencialit krijues të pedagogëve e studentëve të Akademisë së Arteve;
- Aktivizimi i studentëve të sapo diplomuar dhe realizimi i projekteve të përbashkëta student-pedagogë. Praktikë e cila do të përgatisë dhe opinione rreth punësimit të rinjëve pranë AA-së
- Vizibilitet më i madh i programit të AA-së për të krijuar një vazhdimësi për 2011 bazuar në cilësinë artistike dhe marketingun;
- Zhvillimi i jetës artistike të AA-së të shikohet dhe ndjehet si një kontribut në jetën artistike të qytetit të Tiranës;
Krijimi i një bërthame menaxhimi të jetës artistike pranë AA-së e cila të zhvillojë dhe marketingun e ngjarjeve të AA-së;
- Zhvillimi i bashkëpunimit me partnerë të huaj për rritjen e cilësisë duke u koordinuar dhe me fondet dhe projektet europiane IPA etj;



Muaji/Data/Viti	Vendi	Aktiviteti
11/01/10	Fakulteti i Muzikes	M Aleksander Peçi Qendra e Kreacionit dhe Zhvillimit të Kompozicionit Contemporan
11/03/10 ora 19	Salla e Madhe e Koncerteve, Galeria FAP	N Dael Karasani Koncert-Ekspozite "Rrugetim mes Tiranës dhe Gjenevës"
11/08/10 ora 11	Holli i A.A.	B Genc Permeti Post (int-ext) er
11/11/10 ora 11	Salla "Tefta T. Koço" MTKRS	M Fatmir Hysi "Beyond the Notes" Tonin Harapi dhe Thoma Simaku në Kontekstin e Kultures Bashkekohore
11/24/10 ora 19	Black Box	S Donard Hasani "Te dielat"
11/26/10 ora 18	Galeria FAP	B Genc Mulliqi Ekspozite e Arteve Pamore "Udhet"
11/30/10 ora 19	Salla e Madhe e Koncerteve	M Arian Paço "Trofta"
12/01/10 ora 18	Galeria FAP	B Gazmend Leka ART studentor ne Qytetin e Arteve
12/02/10 ora 10	Salla e Pedagogëve	M Merita Rexha Tershana Prezantim i dokumentareve per pianon dhe pianiste te medhenj
12/03/10 ora 10	Salla e Pedagogëve	M Merita Rexha Tershana Prezantim i dokumentareve per pianon dhe pianiste te medhenj
12/06/10 ora 10	Salla e Pedagogëve	M Merita Rexha Tershana Prezantim i dokumentareve per pianon dhe pianiste te medhenj
ora 19	Salla e Madhe e Koncerteve	M Nestor Kraja Festivali i Krijuesve te Rinj

M Fakulteti i Muzikes
B Fakulteti i Arteve të Bukura
S Fakulteti i Artit Skenik
N Projekte Nderdisiplinore



Muaji/Data/Viti	Vendi	Aktiviteti
12/07/10 ora 19	Salla e Madhe e Koncerteve	M Nestor Kraja Festivali i Krijuesve te Rinj
12/09/10 ora 10	Salla e pedagogeve	M Merita Rexha Tershana Prezantim i dokumentareve per pianon dhe pianiste te medhenj
12/13/10, ora 18		S Milto Kutali "Te Brendshmet"
ora 19		M Isak Shehu "Ibrahim Madhi — Koncert per nder te 50 vjetorit te karrieres dhe 65 vjetorit te lindjes"
12/14/10 ora 19	Salla e Madhe e Koncerteve	M Arben Basha Koncert Recital
12/15/10 ora 9-20.30	Mjedise te ndryshme te Akademise se Arteve	N Pjeter Guralumi "DIAPAZON" Dita e Hapur (Open Day)
ora 10	Galeria FAP	B Dylber Neziri Skulptura-Ambienti-Rinia
ora 10.30	Salla e Pedagoqeve	M Zana Prela Tryeze e rrumbullaket e studenteve te Muzikologjise
ora 12	Galeria FAP	B Marvina Cela "Tik- Tak"
ora 12	Galeria FAP	B Gentian Spirollari Figura te shquara te AA-se
ora 12.30	Salla e Pedagoqeve	M Rudina Ciko "Piano romantike" Chopin&Schumann
ora 16		S Gjergj Prevazi "Ne Ku-Nder?" Atelie e koreografise
ora 18	Salla e Pedagoqeve	M Zana Prela Promovim libri
ora 19	Salla e Madhe e Koncerteve	N Pjeter Guralumi "DIAPAZON" Mbremje GALA

Muaji/Data/Viti	Vendi	Aktiviteti
12/16/10 ora 18	Galeria FAP	B Najada Hamza "Folk Fashion Bazar"
ora 19	Salla e Madhe e Koncerteve	A-1 Lorenc Radovani Figura te shquara shkodrane te Artit Shqiptar
12/17/10 ora 18	Galeria e FAP	B Ali Oseku G.A. Grafikart
12/19/10 ora 18	Galeria e FAP Burgu i vjeter Shkoder	N Zef Paci "tran ZI nxhir"
12/20/10 ora 10	Fakulteti i Arteve te Bukura	B Nikolla Thano Skulpture funksionale parku
ora 11	Salla e Pedagoqeve	M Anita Tartari Chopin 24 preludet Koncert & Leksion
ora 18	Fakulteti i Artit Skenik	S Eni Shehu Migjeni ne proze e poezi, pare ne versionin bashkekohor
12/21/10	Galeria FAP	B Edison Ceraj Katalogu i puneve te studenteve, 2009-2010
12/22/10	Galeria FAP	B Ardian Isufi "Fjala" ora 18
12/22/10 ora 18.30	Salla Black Box	S Besnik Bisha Hapesirat studentore ne AA
ora 18.30	Salla e Madhe e Koncerteve	M Fatos Qerimaj Big Band Orchestra
12/22/10 ora 20.30	Salla e Madhe e Koncerteve,	M Petrika Afezolli Academy Grand Galá
12/27/10	Salla e Madhe e Koncerteve	M Burhan Spahiu "Opera e Te Rinjve"

Aleksandër Peçi
"Qendra e Kreacionit
dhe Zhvillimit
të Kompozicionit Kontemporan"
1 Nëntor 2010 e në vazhdim
Fakulteti i Muzikës

Është një projekt afatgjatë dhe i qendrueshëm, që përfshin të gjithë forcat krijuese e interpretese të AA. (Pedagogë, Studentë dhe Bibliotekën e AA-së)

Dael Karasani
"Rrugëtim mes Tiranës
dhe Gjenevës"

Koncert—Ekspozitë
3 Nëntor—10 Nëntor 2010
Salla e Madhe e Koncerteve
Galeria FAP

Është një projekt i integruar mes muzikës dhe ekspozitës fotografike. Kohëzgjatja është 7 ditë duke filluar nga data 3 Nëntor 2010. Fillon me një koncert recital Violonçel e Piano për të vazhduar më tej me një ekspozitë të 18 punimeve fotografike. Është një nga rastet e veçanta të bashkëpunimit mes artistëve të diplomuar pranë AA-së dhe atyre që janë diplomuar jashtë vendit

Genc Përmeti
"Post (int-ext) er"

Ky projekt që ka edhe mbështetjen e Pro Helvetias, ka filluar që në ditët e para të vitit Akademik 2010-2011 dhe është i ndërtuar si një projekt afatgjatë me disa etapa. Realizimi i etapës së parë do të ketë një shtrirje kohore prej 7 ditësh. Rreth 10 artistë të rinj, të cilët do të përzgjidhen nga AA, do të krijojnë postera ku do të shprehin shqetësimet e tyre mbi disa prej aspekteve më të ndjeshme të shoqërisë postkomuniste në vendin tonë siç janë ato sociale, ekonomike dhe politike. Është një projekt gjithëpërfshirë; ai merr jetë në akademinë e arteve por përfshin mbarë qytetin, vizibiliteti i posterave dhe projektimit të tyre nëpër qytet duke u bërë ngacmues dhe tërheqës vëmendje për të gjithë qytetarët.

Fatmir Hysi
"Beyond the Notes"
Tonin Harapi
dhe Thoma Simaku
në Kontekstin e Kulturës
Bashkëkohore
11 Nëntor 2010
Salla "Tefta T. Koço" MTKRS

Mbrëmje muzikore me krijimtarinë e T. Harapit, Th. Simakut e te kompozitorëve të tjerë, konferenca teorike dhe studime muzikologjike, monografike e regjistrime në cd, duke treguar

rolin e këtyre krijuesve në muzikën shqiptare, si dhe duke treguar jo vetëm raportin e profesorit me studentin e tij, por edhe vazhdimin e kësaj tradite drejt orientimeve europiane. Me pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentëve të AA si në debat ashtu dhe në fushën e krijimit dhe interpretimit.

Donard Hasani
"Te dielat"
24-25 Nëntor 2010

Vënie në skenë e një komedie të re, e cila do të promovojë një brez të ri aktorësh, skenografësh, formulues muzike dhe duke shtuar një vepër të re dhe cilësore në repertorin e traditës skenike të Akademisë së Arteve. Për të realizuar thithjen e sa më shumë spektatorëve, përveç mjeteve tradicionale të reklamimit, do të përdoren dhe strategji të reja si thirrja nëpërmjet internetit, lajmërimi nëpërmjet rrjetit celular në baze të një marrëveshjeje, lidhja me një mediapartner etj.

Genc Mulliqi
Ekspozite e Arteve Pamore
"Udhet"
26 Nëntor 2010

Ekspozitë me punimet e kohëve të fundit të artistëve A. Oseku, G. Leka, N. Hamza, V. Myrtezai, G. Mulliqi, I. Butka, F. Miziri, P. Papa,

G. Përmeti, A. Isufi, A. Fusha etj., shoqëruar me një botim dinjitoz për njohjen e veprimtarisë së zgjeruq të stafit të Akademisë të përfshirë në mësimdhënie. dhe për të rritur reputacionin e A.A. si një institucion qendror, promovues dhe aktiv edhe në fushën e arteve pamore.

Arian Paço
"Trofta"
30 Nëntor 2010

Koncert në Fier dhe Tiranë, me kuintetin e titulluar "Trofta" të Schubert, me pjesëmarrjen e Arjan Paço, Lorenc Radovani, Gëzim Belegu, Arben Basha dhe Vojsava Manaj.

Gazmend Leka
"ART studentor
në Qytetin e Arteve"
1 Dhjetor 2010

Ky projekt merr përsipër realizimin e një ekspozitë në të cilën do të ekspozojnë punimet e tyre një grup studentësh të përzgjedhur nga vitet dhe atëlier të ndryshëm. Këto punime do të përzgjidhen nga kri-



jimtaria ë tyrë më ë mirë, gjatë vitëve të funfit të studimëve në Akadëminë ë Artëve.

Merita Rexha Tërshana

"Prezantim i dokumentarëve për pianon dhe pianistë të mëdhenj"
2, 3, 6, 9 Dhjetor 2010

8 aktivitete me filma dokumentarë për të bërë të njohur para studentëve dhe publikut pianistët dhe kompozitorët më të shquar si dhe vepra pianistike te njohura.

Nestor Kraja

"Festivali i Krijuesve të Rinj"
6, 7, Dhjetor 2010

Edicioni i V i Festivalit të Krijuesve të Rinj ku parashikohen 2 koncerte me vepra të studentëve të kompozicionit të cilat do të incizohen në CD.



Isak Shehu

"Ibrahim Madhi – Koncert për nder të 50 vjetorit të karrierës dhe 65 vjetorit të lindjes"
13 Dhjetor 2010

Koncert i Orkestrës së Harqeve të Akademisë së Arteve dedikuar figurës së violinistit dhe pedagogut të mirënjohur, Ibrahim Madhi.

Milto Kutali

"Të Brendshmet"
13 Dhjetor 2010

Komedia "Të brendshmet", është një intrigë e thjeshtë që bëhet burim i humorit të begatë, por edhe i sarkazmës therëse dhe që i përgjigjet shumë mirë realiteteve të sotme të shoqërisë post-tranzicion shqiptare, e cila evidenton përmes modelit konkret vlerat e kastit pedagogjik dhe studentor të F.A.S duke realizuar lidhje të konsoliduara dhe të qendrueshme mes trupës pedagogjike, studentëve, si dhe me gjeneratën e afërt të sapodalë nga auditorët e fakultetit tonë.

Arben Basha

Koncert Recital
14 Dhjetor 2010

Koncert Recital me Kontrabas nga Arben Basha dhe me pjesëmarrjen e Arjan Paço, Lorenc Radovani, Gëzim Belegu etj.

Pjetër Guralumi

"DIAPAZON"

Dita e Hapur (Open Day) për Akademinë e Arteve
15 Dhjetor 2010

Me pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm pedagogësh dhe studentësh nga të tre fakultetet, ky Event i përbërë nga disa aktivitete, fokuson kryesisht njohjen dhe promovimin e studimeve pranë AA-së duke e gërshetuar me promovimin e vlerave më të spikatura të artit bashkëkohor dhe atij të traditës përmes Eventit të Ditës së Hapur (Open Day) për Akademinë e Arteve. DIAPAZON do të ketë të integruar një Mbrëmje Galë pranë Sallës së Madhe të Koncerteve për mbledhjen e fondeve nga komuniteti shqiptar dhe i huaj i biznesit që operojnë në Shqipëri. Fondet do të destinohen për përmirësimin e kushteve për publikun në Sallën e Madhe të Koncerteve të AA-së.

Zana Prela

"Tryezë e rumbullakët e studentëve të Muzikologjisë"
"Promovim Libri"
15 Dhjetor 2010

Tryezë e rumbullakët e studentëve të Muzikologjisë me temë "Muzika Shqiptare e Traditës": kërkime dhe vlerësime. Diskutime mbi kompozitorë dhe vepra të traditës muzikore shq-

iptare të periudhave para dhe mbas Luftës II Botërore, shoqëruar me projeksione të dokumenteve origjinale arkivore etj., si dhe Promovim i librit "Gjergj Antonin në ietë me violoncelin. me autore I. Dema.

Rudina Ciko

"Piano romantike"
Chopin & Schumann
15 Dhjetor 2010

Projekti përfshin një seri koncertesh me pjesëmarrjen e studentëve, për të promovuar studimet pianistike në FM e A.A., për të krijuar modele të bashkëpunimit student-pedagog dhe integruar aktivitetet tona në një kontekst me të gjerë të aktiviteteve europiane të muzikës për nder 200-vjetorit të kompozitorëve Chopin dhe Schuman. Ky projekt parashikon rregjistrimin e një CD i cili do të dorëzohet pranë fonotekës së A.A.

Dylber Neziri

"Skulptura-Ambienti-Rinia"
15 Dhjetor 2010

Ky projekt ka për qëllim të nisë një debat profesional mbi cilësinë e ambientit dhe impaktin që ka skulptura në rritjen



e cilësisë. Realizimi i projekteve dhe boceteve në dimensione të ndryshme. Debat krijues duke vendosur një projekt në një hapësirë virtuale dhe më pas reale si dhe impakti estetik.

Marvina Çela
"Tik- Tak"
15 Dhjetor 2010

Ekspozitë me 19 studentë të FAB midis të cilëve A. Skënderi, A. Hasaj, B. Bitri, E. Deni, E. Bilani, E. Dyli, E. Muçollari, F. Zoto, H. Vogli, I. Sheplo etj. Do të ketë vizibilitet në mediat e shkruara dhe ato elektronike gjithashtu një katalog. Aktiviteti do ketë një hapësirë të vetën dhe në mediat sociale si facebook, linkedin, blog personal si dhe një link prezantues në faqen zyrtare të internetit të AA-së. si dhe do të krijojë një netëork kulturor mbi artet pamore midis AA-së dhe Grupit të artistëve të rinj pjesëmarrës.



Gentian Spirollari
"Figura te shquara te AA-se"
15 Dhjetor 2010

Ky projekt ka për qëllim të pasqyrojë në skulpturë (buste ose medalione të mëdha) disa nga figurat artistike dhe pedagogjike të AA, në fushat përkatëse. (tre buste për secilën) -muzikë-artet figurative-dramaturgj, tëvlerësuar për arritjet e tyre në fushën e artit dhe të pedagogjisë. Në këtë projekt përfshihen studentët të perzgjedhur në bashkepunim me pedagogun. Kjo do të shërbejë për arredimin e holleve të AA me skulpturat sipas degëve përkatëse.

Gjergj Prevazi
"Ne Ku-Nder?"
15 Dhjetor 2010

Projekti, një spektakël dance-theater i ndërtuar në modelin e një atelieri teatro, do të shfaqet me pjesëmarrjen e pedagoges E. Andrea, Gj. Prevazi, E. Bakalli, H. Zacharian, E. Cefa, E. Mataj dhe studentëve M. Nushi, K. Zace, A. Logu, E. Zyberi dhe të sapodiplomuarve S. Hoxha, A. Kondaj, A. Zeneli. Një vepër e Kim Mehmetit

kun duke krijuar një marrëdhënie interaktive krijues-publik.

Lorenc Radovani
"Figura të shquara shkodrane të Artit Shqiptar"
16 Dhjetor 2010

Mbrëmje poetiko muzikore, tryezë e rrumbullaket, koncert me artistë të rinj të AA, aktorëve të zgjedhur dhe nxënësve të Shkolës Prenk Jakova. Ekspozitë Fotografike.

Najada Hamza
"Folk Fashion Bazar"
16 Dhjetor

Ky projekt parashikon afrimin e elementeve dhe krijimeve të pasura të folklorit të të gjitha trevave të vendit tonë nëpërmjet veshjeve, aksesoreve si dhe krijimeve të tjera në jetën e përditshme të individit në ditët e sotme, si dhe krijimin e veshjeve duke u bazuar në traditën tonë popullore përbën një nga elementet më themeltare në fashionin kontemporan, gjë që shihet si një nga elementet më bashkëkohore. Bazar, që në terminologji i përket orientit, në të vërtetë është konvertuar në një mënyrë të re marketingu sidomos i krijimeve që në vetvete përfaqsojnë elementet kombëtare, duke i sjelle në jetën moderne. Ky plan përkon edhe me një marrëdhënie të drejtpërdrejtë që krijuesit e rinj do të kenë me vizitorët dhe publi-

Ali Oseku
"G.A. Grafikart"
17 Dhjetor 2010

Workshop me Grafistin C.Tanhauser. Përpunimi dhe përfundimi i Grafikave dhe i librit të përbashkët studentor. Ekspozitë me punime grafike për pedagogët, studentët e AA dhe për publikun artdashes.

Zef Paci
"tran ZI nxhir"
19 Dhjetor 2010

Projekti tran ZI nxhir është një projekt ndërdisiplinor që përfshin në vetvete art pamor, dramatik, muzikor dhe koreografik. Projekti do zhvillohet në mjediset e burgut të vjetër të Shkodrës, autentik dhe famëkeq për masakrat dhe abuzimet flagrante mbi të drejtat e njeriut gjatë periudhës së komunizmit. Duke qenë se në këto mjedise, që kanë shërbyer si paradhomat e vdekjes, janë përshkruar nga personalitete të artit



dhe kulturës së blasfemuar shqiptare si: A. Harapi, V. Prenushi, A. Pipa, Z. Pëllumbi, Z. Zorba, S. Repishti etj pjesë e rëndësishme e kësaj performace do të jenë edhe tekstet e tyre dokumentare dhe artistike. Një grup pedagogësh të disiplinave të ndryshme artistike Z. Paci, F. Qerimi, Gj. Prevazi, S. Capaliku së bashku me një grup studentësh nga të tre fakultetet, do të shfrytëzojnë të gjitha mjediset dhe kthinat e burgut të vjetër, për të ekspozuar videot, filmat, tekstet, kolonat zanore, instalacionet dhe lëvizjet brenda konceptit të një vizite në këtë muze të pashpallur të diktaturës.

Anita Tartari
"Chopin 24 preludet"
Koncert & Leksion
20 Dhjetor 2010

Do të interpretohen 24 Preludet e Chopin si dhe do të realizohet një analizë e kësaj veprë.

Nikolla Thano
Skulpture funksionale parku
20 Dhjetor 2010

Skulptura Funksionale parku (stola) do të derdhen në granil. Ky projekt drejtohet nga Nikolla Thano dhe Ergys Krisiko dhe do të angazhojë 6 studentë. Këto Skulptura do të ekspozohen dhe vendosen në oborret dhe kopshtet e AA-së duke i dhënë këetyre vlera artistike dhe duke u vënë në shërbim të komunitetit studentor. Gjithashtu kjo mund të jetë baze për bashkëpunime edhe me akademi të tiera të huaja për projekte të tilla duke i ekspozuar skulpturat në parqe dhe hapësira publike për të rritur vizibilitetin e AA-së.

Eni Shehu
"Migjeni në prozë e poezi,
parë në versionin bashkëkohor"
20 Dhjetor

Kursi i II-të dhe i IV-rt që kanë punuar në vitet përkatëse me pedagogen Ermira Gjata do të jenë protagonistët e kësaj performace bazur në veprat e prozatorit dhe poetit tonë Migjeni. Kjo do të jetë dhe një mënyrë për te prezantuar një punë të bërë

përgjatë një viti për marrjen e elementeve bazë dhe përpunimin e veçantë të kësaj veprë.

Edison Ceraç
"Katalogu i punëve të studentëve,
2009-2010" 21 Dhjetor 2010

Botimi i Katalogut është një projekt që flet për botimin e punëve të studentëve dhe mund të krijojë në precedent për punet (detyrimet) mësimore të studentëve në të gjitha fakultetet.

Ardian Isufi
"Fjala"
22 Dhjetor 2010

Fjala -Teksti dhe Konteksti- Ekspozitë e cila do të përfshijë skulpturën, vizatimin, dokumentarin artistik, fjalën e shkruar, performancës etj. dhe debatin artist publik. Me pjesëmarrjen e N. Hamza, Ali Oseku, Gazmend Leka, V. Myrtezai etj. I ftuar Fatos Lubonja.

Fatos Qerimaj
"Big Band Orchestra"
Salla e Madhe e Koncerteve
22 Dhjetor 2010, ora 18.30

Përveç përfshirjes në eventet më të rëndësishme të AA-së, në këtë projekt do jetë realizimi i një

kompozimi të ri muzikor i cili do të finalizohet me një videoclip, ku do të pasqyrohen fragmente nga jeta dhe puna e studentëve & pedagogëve të AA në Programin "Qyteti i Arteve". Repertori i këtij formacioni muzikor është përzgjedhur dhe përshtatur posaçërisht për eventet e Akademisë së Arteve.

Besnik Bisha
"Hapësirat studentore në AA"
23 Dhjetor 2010

Në qendër të projektit do të jetë një dokumentar në të cilin do të pasqyrohen të gjitha aktivitetet që mund të kryhen në ambientet e Akademisë së Arteve. Ky projekt ka si qëllim të pasqyrojë mundësitë e Akademisë për të përgatitur studentët (artistët e ardhshëm) në degët speciale të



tyre, cilat janë këto degë, historikun e secilës prej tyre, si dhe ambientet ku ato zhvillohen edukimi profesional i tyre..etj

Petrika Afezolli
"Academy Grand Gala"
22 dhjetor, ora 20.30
Salla e madhe e Koncerteve.

Projekti parashikon një koncert vokalo-instrumental me orkestrën e Akademisë së Arteve dhe pjesëmarrjen e sopranove M. Leka, Sh. Zani, S. Frasheri, me të ftuar speciale pianisten Nora Çashku nën drejtimin e P. Afezollit. Projekti Academy Grand Gala me pretendimet e stafit organizues

do të jetë pjesë e prezencës së tij me standarte cilësore në mediat e ndryshme kombëtare vizive.,

Burhan Spahiu
"Opera e Te Rinjve"
27 Dhjetor 2010

Me një staf artistik që përbëhet prej: N. Gurakuqi (regjisor dhe skenograf) A. Lepuri, D. Lumshi (dirigjentë) T. Pustina (pikturues kostumesh), E. Llozi, E. Peçi (koncertmaester) konsulent artistik B. Spahiu, si dhe me pjesëmarrjen e studentëve dhe të sapodiplomuarve si solistë dhe koristë: F. Sali, S. Alla, O. Islami, V. Saliu, M. Koci, Sh. Gega, E. Pepa, E. Lloshi, etj do të vënë në skenë operan Don Giovanni.

